


Zhvillohet takimi i dytë i Komitetit Ekzekutiv të Konferencës Ndërkombëtare të Komisionerëve të Informimit (ICIC)



Komiteti Ekzekutiv i Konferencës Ndërkombëtare të Komisionerëve të Informimit (ICIC) zhvilloi më datë 28 maj 2025 takimin e dytë online për këtë vit.

Ky takim, u drejtua nga Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale z. Besnik Dervishi në cilësinë e Presidentit të këtij Komiteti Ekzekutiv.


Në këtë sesion morën pjesë Komisionerët e së Drejtës për Informim nga vende anëtare si Gjermania, Australia, Argjentina (Buenos Aires), Kenia, Bermuda, Afrika e Jugut, Sierra Leone.

Komisioneri Dervishi vlerësoi punën dhe angazhimin e autoritetit gjerman si mikpritës i radhës i edicionit të XVI të Konferencës Ndërkombëtare të Komisionerëve të Informimit, që do të mbahet në datat 23-25 qershor 2025 në Berlin.

Anëtarët e Komitetit morën disa vendime të rëndësishme lidhur me përzgjedhjen e mikpritësit të edicionit të XVIII-të, që do të zhvillohet në vitin 2027, si dhe lidhur me thirrjen për përzgjedhjen e autoritetit që do të mbajë rolin e Presidentit/Sekretariatit të këtij forumi të rëndësishëm për periudhën 2025-2027. Gjithashtu, anëtarët e Komitetit shqyrtuan kërkesat e tre aplikantëve të rinj për t'iu bashkuar ICIC me statusin e vëzhguesit, të cilat u miratuan me konsensus.

Zyra e Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale mbetet e angazhuar në ndjekjen me përgjegjësi të gjitha proceset dhe aktivitetet e këtij forumi të rëndësishëm ndërkombëtar, si dhe përfaqësimin dinjitoz të vendit tonë në arenën e marrëdhënieve ndërkombëtare.

Zyra e Komisionerit trajnon koordinatorët e rinj për të drejtën e informimit të 45 autoriteteve publike



Zyra e Komisionerit vijon angazhimin e saj me qëllim rritjen e kapaciteteve të koordinatorëve të së drejtës për informim në zbatim të kuadrit ligjor për të drejtën e informimit.

Më datë 30 maj 2025, Zyra e Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale zhvilloi një trajnim online me koordinatorët e rinj për të drejtën e informimit të rreth 45 autoriteteve publike.

Trajnimi u fokusua në ndryshimet e ligjit për të drejtën e informimit dhe risitë që këto ndryshime kanë sjellë, si dhe zbatimin në praktikë të rasteve konkrete. Koordinatorët e rinj u njohën me detyrimet specifike mbi publikimin/përditësimin e regjistrit të kërkesave dhe përgjigjeve, si dhe përdorimin e Regjistrit Elektronik të Kërkesave dhe Përgjigjeve (REKPD) nëpërmjet portalit pyetshtetin.al.

Zyra e Komisionerit do të vijojë të mbështesë koordinatorët e së drejtës për informim të caktuar rishtazi me trajnime periodike, që i shërbejnë edukimit dhe rritjes së njohurive lidhur me transparencën dhe llogaridhënien e autoriteteve publike.

Vendimmarrja e Komisionerit

Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale gjatë muajit maj 2025 ka dhënë 4 vendime në zbatim të ligjit 119/2014 "Për të drejtën e informimit", i ndryshuar (në vijim "LDI"). Sipas Vendimit nr. 10, datë 22.05.2025, Komisioneri ka pranuar ankesën ndaj Autoritetit Publik "Urdhri i Psikologut" me objekt "Ankim ndaj refuzimit për dhënie informacioni dhe kopje të dokumenteve zyrtare". Ankuesi, me anë të kërkesës së datës 04.04.2025, depozituar në adresën elektronike sekretaria@urdhriipsikologut.al, ka kërkuar t'i vendoset në dispozicion informacioni/dokumentacioni, në lidhje me:

1. Pasqyra Financiare për vitin 2024 të Urdhrit të Psikologut.
2. Projekt-Buxheti i vitit 2025 i detajuar, i miratuar me vendimin nr. 20, datë 12.12.2024 të Këshillit Kombëtar, i shoqëruar me relacionin përkatës të plotë të nënshkruar nga të gjithë anëtarët pjesmarrës ose listë prezencën e pjesmarrjes në mbledhje.
3. Buxhetin faktik të Urdhrit të Psikologut, miratuar me vendimin nr. 1, datë 05.07.2024 të Asamblesë Kombëtare të Urdhrit.

Ankuesi, me pretendimin se është cenuar në të drejtën për informim, ka depozituar pranë Zyrës së Komisionerit ankesën e regjistruar me nr. 1273 prot., datë 22.04.2025. Komisioneri, pas shqyrtimit paraprak të ankesës, bazës ligjore dhe rrethanave të faktit të paraqitura në të, vlerësoi se ankesa përmbush kriteret formale ligjore, të përcaktuara në nenin 24 të ligjit nr. 119/2014 "Për të drejtën e informimit", i ndryshuar (në vijim "LDI"). Nëpërmjet vijimit të ankesës, rregjistruar pranë Zyrës së Komisionerit me nr. 1273/2 prot., datë 07.05.2025 dhe nr. 1273/3 prot., datë 19.05.2025, ankuesi ka informuar se ende nuk i është vënë në dispozicion informacioni/dokumentacioni i kërkuar.

Në përputhje me nenin 10 të ligjit nr. 44/2015 "Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë", i cili parashikon: "Organi publik siguron që të gjitha palët dhe persona të tjerë të përfshirë në procedurë të jenë në gjendje të ndjekin dhe të mbrojnë të drejtat dhe interesat e tyre ligjorë në mënyrë sa më efektive dhe të lehtë të jetë e mundur", Komisioneri nëpërmjet shkresës nr. 1273/1 Prot., datë 25.04.2025, ka kërkuar nga Autoriteti Publik të informohet mbi trajtimin, apo procedurën e ndjekur, lidhur me kërkesën për informacion, si dhe sqarime për disponimin e dokumentacionit të kërkuar.

Nga shqyrtimi i çështjes, konstatohet se objekti i kërkesës lidhet me dokumentacion i cili është prodhuar dhe zotërohet nga Autoriteti Publik, i cili ka të bëjë me gjendjen dhe përdorimin e fondeve të vetë autoritetit.

Sipas LDI, Urdhri i Psikologut, është Autoritet Publik dhe subjekt i këtij ligji. Për rrjedhojë ky autoritet detyrohet për zbatimin e tij, duke garantuar njohjen e publikut me informacion në kuadër të transparencës.

Për të mundësuar realizimin e objektit dhe qëllimit të tij, LDI, në pikën 1 të nenit 1 përcakton se: "1. Ky ligj rregullon të drejtën e njohjes me informacionin që prodhohet ose mbahet nga autoritetet publike.

Në këtë kuptim, çdo autoritet publik pavarësisht nëse është në cilësinë e "prodhuesit" apo "mbajtësit" të informacionit, detyrohet të garantojë njohjen e publikut me informacion, në kuadër të ushtrimit të të drejtave dhe lirive të individit në praktikë, si dhe të formimit të pikëpamjeve për gjendjen e shtetit dhe të shoqërisë.

Komisioneri vlerëson se, refuzimi për të dhënë dokumentacionin e kërkuar nga ankuesi në kërkesën e datës 04.04.2025, depozituar në adresën elektronike sekretaria@urdhriipsikologut.al, bie në kundërshtim jo vetëm me parashikimet e neneve të sipërcituara por edhe me parashikimet e shkronjës "e" të pikës 2 të nenit 7 të LDI i cili shprehet se: "...të dhëna për buxhetin dhe planin e shpenzimeve për vitin financiar në vijim dhe vitet e kaluara, si dhe çdo raport vjetor për zbatimin e buxhetit. Në ato raste kur autoriteti publik vetëfinancohet nga tarifat e licencave ose çdo formë tjetër e financimit të drejtpërdrejtë nga subjektet e rregulluara prej tij, bëhen publike edhe dokumentet që tregojnë gjendjen e shlyerjes së detyrimeve nga subjektet e licencuara...".

Referuar parashikimeve të nenit 15 të LDI, moskthimi i një përgjigjeje nga ana e Autoritetit Publik brenda afateve të parashikuara në ligj do të konsiderohet si refuzim i dhënies së informacionit/dokumentacionit në respekt të pikës 4 të nenit 15 të LDI, e cila shprehet se: "...Në çdo rast, mostrajtimi i kërkesës për informim brenda afateve të sipërpërmendura do të konsiderohet refuzim...".

Për sa më sipër, Autoriteti Publik, pasi të shqyrtonte kërkesën për informim të ankuesit, duhet të kishte marrë parasysh vetëm parashikimet e pikës 6 të nenit 17 të LDI, sipas të cilit "Nëse kufizimi prek vetëm një pjesë të informacionit të kërkuar, pjesa tjetër nuk i refuzohet kërkuarit. Autoriteti Publik tregon qartë pjesët e dokumentacionit përkatës që janë refuzuar, si dhe në bazë të cilës pikë të këtij neni është bërë ky refuzim".

Për sa më sipër, informacioni i kërkuar, përmbush kërkesat e pikës 2, të nenit 2 të LDI, sipas të cilit "informacion publik konsiderohet çdo e dhënë e regjistruar në çfarëdo lloj forme dhe formati, gjatë ushtrimit të funksionit publik pavarësisht nëse është përpiluar ose jo nga Autoriteti Publik". Rrjedhimisht, ekzistenca e informacionit/dokumentacionit të mësipërm pavarësisht nëse ai është i prodhuar apo administrohet nga Autoriteti Publik, ngarkon me përgjegjësi këtë të fundit, për vënien në dispozicion të informacionit të kërkuar.

Në përfundim Komisioneri vendosi pranimin e ankesës dhe urdhërimin e Autoritetit Publik, për vënien në dispozicion të dokumentacionit sipas kërkesës për informacion.

Për më shumë informacion rreth vendimmarrjes së Komisionerit, mund të vizitoni faqen zyrtare të Komisionerit www.idp.al.

Komentari “Mbi kuptimin dhe zbatimin e ligjit për të dhënat e hapura dhe ripërdorimin e informacionit në sektorin publik”



Zyra e Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, në bashkëpunim me projektin e Bashkimit Evropian për Qeverisjen e Mirë, ka hartuar Komentarin “Mbi kuptimin dhe zbatimin e ligjit për të dhënat e hapura dhe ripërdorimin e informacionit në sektorin publik”. Komentari ka për qëllim lehtësimin e zbatimit të ligjit nr. 33/2022 dhe shërben si një udhëzues praktik për të gjithë organet e sektorit publik ose sipërmarrjet publike për të lehtësuar kuptimin dhe interpretimin e koncepteve të reja që ky ligj prezanton, për të shpjeguar mënyrën se si do të përmbushen detyrimet ligjore në lidhje me të dhënat e hapura dhe ripërdorimin, si dhe mekanizmat që do të përdoren për mbrojtjen, mbikëqyrjen dhe promovimin e të drejtës për ripërdorim.

Ky akt synon t’u vijë në ndihmë, punonjësve të ngarkuar me detyrat e publikimit të të dhënave të hapura dhe ripërdorimin e dokumenteve, si dhe çdo aktori tjetër (biznes, shoqëri civile, media, qytetar) të përfshirë drejtëpërdrejtë apo tërthorazi në këtë proces, të njohin më mirë rregullat e zbatueshme në situata konkrete, me synimin final të krijimit të një sistemi funksional të të dhënave të hapura dhe ripërdorimit të tyre, me qëllim të nxitjes së inovacionit në ofrimin e produkteve dhe të shërbimeve.

Hartimi i këtij Komentari u parapri nga sesion trajnimi për trajnerët (ToT), mbi zbatimin efektiv të ligjit për të dhënat e hapura dhe ripërdorimin e informacionit të sektorit publik nga ekspertët e projektit të Bashkimit Evropian për Qeverisjen e Mirë, e më pas nga një tryezë diskutimi me pjesëmarrjen e përfaqësuesve të organeve të sektorit publik dhe sipërmarrjeve publike. Çështjet e evidentuara gjatë diskutimeve u përfshinë në Komentari, me qëllim sqarimin e çdo aspekti që merr rëndësi në zbatim të ligjit nr. 33/2022.